



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/206
Datë: 21.05.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 maj 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi për shpërbërjen vullnetare të Ndërmarrjes Publike Qendrore "Ndërmarrja e Re Energjetike e Kosovës (NKEC)" Sh. A.
2. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.07/47, i datës 15 maj 2018 për Themelimin e Ndërmarrjes së Re Energjetike të Kosovës Sh. A./NKEC.
3. Obligohet Njësia për Politikat dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike të ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi, duke përfshirë sidomos njoftimin e shpërbërjes vullnetare dhe veprimet e tjera të parapara me nenin 212 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë